



Organization for Security and
Co-operation in Europe
Mission to Skopje



KONFERENCA E PARË STUDENTORE

"STABILITETI SHOQËROR , SUNDIMI I SË DREJTËS DHE MOSDISKRIMINIMI"

Universiteti “Goce Dellçev” – Shtip, Fakulteti Juridik

“Universiteti Shtetëror i Tetovës”, Fakulteti Juridik

Fakulteti Juridik pranë Universitetit “Goce Dellçev” në Shtip dhe Fakulteti Juridik pranë Universitetit shtetëror të Tetovës, përkrahur nga Misioni i OSBE-së në Shkup, ftojnë studentët të marrin pjesë me punimet e tyre në Konferencën e parë Shkencore (për studentët nga të gjitha fakultetet juridike) të titulluar “**Stabiliteti shoqëror, sundimi i së drejtës dhe mosdiskriminimi**”, e cila do të mbahet për herë të parë në Universitetin Shtetëror të Tetovës me **3 tetor 2016**.

I ftojmë te gjithë studentët që vijojnë studimet e tyre në të gjitha fakultetet juridike të kontribuojnë nëpërmjet ndarjens së hulumtimeve, ideve dhe mendimeve të tyre mbi tema të ndryshme nga fusha e ligjit, shkencës politike, sociologjisë, mediave dhe komunikimeve (të ndërlidhura me stabilitetin shoqëror, mosdiskriminimin dhe sundimin e së drejtës).

Studentët mund të hulumtojnë lidhur me çështjet si vijon:

- Mbrojtja e të drejtave të njeriut në globalizimin shoqëror;
- Gjuha e urrejtjes në media;
- Mbrojtja e të drejtave të grupeve etnike ;
- Imponimi i roleve në shoqëri;
- Diskriminimi në marrëdhëniet e punës;
- Stabiliteti shoqëror në sferën multikulturale;
- Përfaqësimi në sferën politike;
- Liria e shprehjes në nivelin nacional;
- Korniza ligjore për barazi gjinore;
- Personat me aftësi të kufizuara dhe qasja e tyre në drejtësi;
- Diskriminimi në bazë të përkatësisë;
- Krimi i urrejtjes dhe grupet e marginalizuara;
- Diskriminimi në tregun e punës;
- Sundimi i lligjit- paktët ndërkombëtare, praktika;
- (Jo)diskriminimi dhe varfëria;
- Diskriminimi në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.

Datat e rëndësishme

Dorëzimi i abstrakteve: 20 shtator 2016 (maksimum 250 fjalë)

Njoftimi për pranimin e abstrakteve: 26 shtator 2016

Dërgimi i punimeve të plota: 26 mars 2017

Gjuhët

shqipe, maqedonase dhe angleze

Informacione Plotësuese

- **Punimet nga konferenca do të publikohen në revistën shkencore ndërkombëtare “STUDENT’S SOCIAL SCIENCE JOURNAL” e dedikuar për studentët e ciklit të parë, të dytë dhe të tretë të studimeve;**
- **Nëse punimet janë në gjuhën shqipe ose maqedonase, përveç gjuhës së zgjedhur duhet të jenë edhe në gjuhën angleze;**

- Një autor mund të paraqitet me një punim si autor i parë dhe si bashkautor në një punim tjetër.

Kontakt

Abstraktet dhe punimet duhet të dërgohen tek: studentconference16@gmail.com

Ju lutem na kontaktoni për çdo pyetje plotësuese.

Rregullat për përgatitjen e një materiali shkencor

1. Struktura e punimit shkencor duhet të përfshijë elementet e mëposhtme:

- Titulli, të jetë i shkruar me shkronja të mëdha, **bold**, 12;
- Emri dhe mbiemri i autorit (bashkautorit), **bold** 12;
- Abstrakti të jetë i shkruar në gjuhën maqedonase dhe angleze, respektivisht gjuhën shqipe dhe angleze(secili abstrakt të përmbaj jo më shumë se 250 fjalë);
- Keywords (fjalët kyçe), 3-5 fjalë kyçe të cilat nuk janë të përfshira në titull;
- Hyrje;
- Materiali dhe metodat e punës;
- Rezultatet;
- Përfundim (Vërejtjet përfundimtare);
- Literatura;

2. Përgatitja e dorëshkrimit

Dorëshkrimi duhet të përgatitet plotësisht në përputhje me rregullat e mëposhtme: dorëshkrimi duhet të jetë i shkruar në gjuhën maqedonase, shqipe ose angleze në MS Word, format A4, duke përdorur Arial për gjuhën maqedonase me mbështetje për alfabetin cirilik, me mbështetje për alfabetin latin për gjuhën shqipe, si dhe me mbështetje për gjuhën angleze me shkronjat latine, me numër "12" të shkronjave, ndarje "Spacing" (1,5), duke balancuar (justify) gjithë dokumentin dhe kufijtë: lart, poshtë, majtas dhe djathtas (2,54 cm), si dhe çdo faqe të shënohet me numrin përkatës..

3. Citimi i literaturës

(APA Style)

Për librat:

Farkash, L., & Petrovski, S. (2012) Doracak për trajnim të gjykatësve në fushën e mosdiskriminimit. Shkup: Sken Point

Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratik dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR), & Misioni i OSBE-së në Shkup. (2014) Të kuptuarit e krimeve të urrejtjes (botim i reviduar), Shkup: Sken Point

Për kapitullin e librit:

Poposka, Zh. Stereotipat dhe paragjykimet si shkas të praktikave diskriminuese- vështrim i praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut, më 16 nëntor - Dita ndërkombëtare e tolerancës (tekste të përzgjedhura). Shkup: Poliesterdej, 45-60.

Për revista:

Poposka, Zh. Pranimi i Bashkimit Evropian në Konventën e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara. Revistë për Çështje Evropiane 'Evrodijalog' Vëllimi 18, 38-50.

Për përmbledhje, reviste vjetore dhe antologji:

Petrova, T. (2015). Diskriminimi i shumëfishtë, Vjetor. Fakulteti Juridik, Universiteti Goce Dellçev - Shtip, V, 225-236.

Për prezantime nga konferenca ose takimeve shkencore:

Dimitrovski, D., Stafilov, B., Miravcievska, V. (2004). Prodhimi organik i farave të perimeve. Simpoziumi i VIII-të i Agroindustrisë, Velika Plana, Serbi dhe Mali i Zi, Procedurat, 252-259.

Për shtypin ditor:

Taleski, B. (2008, 15 mars). Menaxhimi i përgjithshëm në menaxhimin e rrjetit të informacionit Infoservis. Biznesi, fq. 8.

Për enciklopedi:

Sturgeon, T. (1995). Science fiction. The Encyclopedia Americana (Vol. 24, pp, 390-392). Dabury, CT: Grolier.

Web faqe:

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë. Lufta e përbashkët kundër krimeve të urrejtjes. Vizita e fundit më 4 mars 2016 www.osce.org

Pas çdo kapitulli të ri, të lihet një hapësirë e zbrazët . Të mos lihet hapësirë e zbrazët midis titullit dhe tekstit!

Vëllimi i tërë punimit të përmbajë jo më shumë se 3000 fjalë.